

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

P.nr.1116/16

26.01.2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm-

Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Hysnije Gashi, me Praktikanten Magbule Rrahmani, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1157-6/16 të dt. 30.11.2016, për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPRK –së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokuroria Themelore në Ferizaj, PP/II.nr. 1157-6/16 të dt.30.11.2016 për dhënien e urdhërit ndëshkimor, gjykata me dt.12.12.2016 mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1157-6/16 të dt. 30.11.2016 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, i lindur me dt: [REDACTED], në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANE FAJTORË

Sepse me dt.09.07.2016, rreth ores 11:40 në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në rajonin ekonomik pyjor Nerodime – Jezerc në vendin e quajtur “Firishta”, me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 1 copë dru të llojit ah, me dimensione të gjata-boniteti III m, me diameter 65 cm, gjithsejtë në kubaturë prej 3.63 m, të cilin e ka transportuar me traktor [REDACTED], vlera e demit të shkaktuar është 490.05 €,

Me të cilën kryen veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPRK-së

Gjykata në bazë të nenit 4,7,21,41,43,46,49,të KPRK-së 365 , të KPPK-së

G J Y K O N

Denim me gjobë në lartësi prej 200 Euro (dy qind Euro) të cilin denim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

Në rast se denimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe forma tjera sipas nenit 39 të KPK-së ,do të shëndrrohet në denim me burg, ashtu që për çdo 20 euro do të i llogaritet me 1(një) ditë burg.

E dëmtuara [REDAKTUAR] Ferizaj, për kërkesën pasurore juridike në bazë të nenit 459 par. 1 të KPPK-së e udhëzon në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr,1157-6/16.të dt. 30.11.2016 ka akuzuar të pandehurit [REDAKTUAR], për vepër penale vjedhje pylli nga neni 358 me par.1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga të pandehurit.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës, procesverbalit me nr. 302/2016 i dt. 11.07.2016, fletëparaqitjës së rojës së pyllit të Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari- Sektori i Pylltarisë në Ferizaj me nr. 302/2016 i dt. 11.07.2016, për vlerësimin e dëmit, si dhe provat e tjera vërtetojnë se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpall fajtor dhe i shqipton dënimin sipas ligjit.

E dëmtuara [REDAKTUAR] Ferizaj, për kërkesën pasurore juridike në bazë të nenit 459 par. 1 të KPPK-së e udhëzon në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 55 euro, dhe të paushallit gjyqësor 20 euro, në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM

DIVIZIONI PENAL

P.nr. 1116/16 dt. 12.12.2016

Praktikante
Magbule Rrahman

Gjyqtarja,
Hysnije Gashi



UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim,
në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimin të aktgjykimit
të njëjtës gjykatë.